

Znj. Valdete Berisha ka mbaruar studimet e larta të nivelit “Master Shkencor” në profilin “Agrobiznes”, në Fakultetin e Ekonomisë dhe Agrobiznesit, Universiteti Bujqësor i Tiranës.

Në vitin 2016, është certifikuar në kualifikimin Pasuniversitar “Vlerësimi i Pasurive të Paluajtshme” pranë Fakultetit të Inxhinierisë së Ndërtimit, Universiteti Politeknik i Tiranës.

Karrierën profesionale e ka filluar që prej vitit 1996, si ekonomiste apo detyra të ndryshme në Administratën Publike.

Në muajin Shkurt 2013 ka filluar punë në KLSH, në pozicionin e Auditueses së Parë në Departamentin e Auditimit të Institucioneve Qendrore. Përgjatë viteve të punës në KLSH ka qenë pjesë e Departamentit të Auditimit të Shoqërive Publike dhe Investimeve të Huaja, Departamentit të Auditimit të Aseteve dhe Mjedisit, si dhe Departamentit të Auditimit të Performancës në pozicionin Audituese e Parë dhe Audituese e Lartë.

Aktualisht, znj. Berisha ushtron detyrën e “Kryeauditueses” në Departamentin e Auditimit të Buxhetit të Shtetit.

Gjatë punës në KLSH ka marrë pjesë në trajnime, konferenca dhe seminare të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, si në Turqi, Poloni, etj., për çështje të auditimit të jashtëm publik, auditimit të mjedisit, auditimit financiar dhe të përputhshmërisë, etikës dhe burimet njerëzore në institucionet supreme të auditimit, prokurimet publike, mashtrimin dhe korrupsionin, etj.